



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 23.1.2025

Nr: 29

**VENDIM**  
**PËR**

**EMËRIMIN E NDIHMËSAVE TË AUDITËVE TEKNICIENË PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE SI DHE LISTAVE TË ZGJEDHËSVE ME BANIM JASHTË VENDIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të shkronjës “n” të pikës 1 të nenit 19, pika 11 e nenit 25 dhe pikat 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V E N D O S I N:**

1. Emërimin si ndihmësive të auditit teknikien, z. Laert Kraja, për mbikëqyrjen e hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025:
  - z. Krenar Fortuzi
  - z. Ilir Stojku
2. Caktimin e masës së shpërblimit në vlerën 236.664 (dyqind e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, për ndihmësin e auditit teknikien për periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raporteve përfundimtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 23.1.2025 Nr: 29



“Për emërimin e ndihmësive të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”